



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)

**Nr. 99**

**Datë 30 qershor 2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 19.6.2014	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2013 .....	3871
Rezolutë e Kuvendit datë 19.6.2014	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2013 .....	3873
Dekret nr. 8599 datë 18.6.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare .....	3874
Udhëzim i ILDKPKI nr. 1, datë 27.6.2014	Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike .....	3875
Vendim i ERE nr. 45, datë 16.6.2014	Për autorizimin e administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. ....	3883
Vendim i ERE nr. 46, datë 16.6.2014	Për autorizimin e kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë	3884
Kërkesë e MTI nr. 3240, datë 17.6.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qukës - Qafë-Pllaçë”, loti 1 (devijimi) .....	3884
Kërkesë e MTI nr. 2990/2, datë 18.6.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit kryesor të kanalizimeve dhe Impiantit të Përpunimit të Ujërave të Përdorura në plazhin e Velipojës .....	3886
	Kërkesë për shpallje të vdekur të shtetasit Arben Koti.....	3886

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË  
BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2013****Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke vlerësuar rolin kushtetues të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e pavarur të politikës monetare;

- Duke e konsideruar të rëndësishme politikën monetare për zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit;

- Duke u mbështetur në objektivat vjetorë e afatmesëm, si dhe detyrimet ligjore të institucionit;

- Duke marrë në konsideratë ndikimin e zhvillimeve ekonomike kombëtare, rajonale e botërore në politikën monetare të ndjekur nga institucioni;

- Duke mbështetur dhe nxitur bashkëpunimin me këtë institucion;

**Konstaton se gjatë vitit 2013:**

1. Banka e Shqipërisë ka realizuar objektivin e saj kryesor, kushtetues dhe ligjor, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke e mbajtur inflacionin brenda objektivit të programuar.

2. Nëpërmjet ndjekjes dhe zbatimit të një politike monetare të kujdesshme, Banka e Shqipërisë ka ndikuar në ruajtjen e mjedisit ekonomik, frenimin e rënies së rritjes ekonomike përtej kufijve kritikë dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik e financiar të vendit.

3. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë është përcjellë pozitivisht në tregjet financiare, por nuk është reflektuar sa dhe si duhet në ekonominë reale. Ndërsa tregjet financiare kanë qenë likuide, në ekonominë reale është konstatuar rënie e kërkesës për kredi nga bizneset dhe individët, si dhe rënie e ofertës së kreditimit nga sistemi bankar.

Kredia për ekonominë, në fund të vitit 2013, është reduktuar me 1,2 për qind ose 7 miliardë lekë, krahasuar me një vit më parë. Kjo rënie është konstatuar në kreditimin e biznesit dhe, veçanërisht, në kredinë për investime.

Fleksibiliteti i ndryshimit të normës së interesit ka qenë i kufizuar dhe jo shumë efektiv dhe, me gjithë ndryshimet e bëra, ndikimi në ekonomi ka qenë i papërfillshëm. Kjo edhe pse Banka e Shqipërisë ka miratuar disa ndryshime rregullatore për të stimuluar bankat e nivelit të dytë në drejtim të rritjes së kreditimit, duke i dhënë përparësi sektorit privat.

4. Banka e Shqipërisë ka marrë disa masa në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator për reduktimin e kredive me probleme, përmirësimin e cilësisë së kreditimit dhe forcimin e rolit mbikëqyrës ndaj sistemit bankar. Por këto masa duket se kanë qenë të pamjaftueshme dhe nuk kanë dhënë efektin e duhur, pasi gjatë vitit 2013 u konstatua një përkeqësim i mëtejshëm i cilësisë dhe standardeve të kreditimit. Kreditë me probleme, në fund të vitit 2013, arritën rreth 23,5 për qind të totalit të kredive.

5. Sistemi bankar shqiptar mbetet ende i mirëkapitalizuar dhe likuid. Banka e Shqipërisë analizon funksionimin e tij, mbështetur në metodologji me bazë risku dhe përcakton masat përkatëse për të parandaluar goditjet nga rreziqet që e kërcënojnë këtë sistem.

Nga disa prova të ushtruara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, në disa banka janë konstatuar mangësi dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse në drejtim të rritjes së nivelit të kapitalit, përmirësimit të menaxhimit etj.

6. Sistemi i pagesave ka funksionuar në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, duke kontribuar në zbatimin me efektivitet të politikës monetare, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe të besueshmërisë së publikut në monedhën kombëtare. Kuvendi vlerëson kontributin e Bankës së Shqipërisë në përgatitjen e ligjit për sistemin e pagesave, i cili u miratua gjatë vitit të kaluar. Bazuar në këtë ligj, Banka e Shqipërisë miratoi kuadrin rregullator dhe licencoi operatorin e parë të skemës kombëtare të pagesave me kartë.

7. Banka e Shqipërisë ka ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit valutor, nëpërmjet aplikimit të një regjimi të luhatshëm të tij.

8. Banka e Shqipërisë ka prodhuar, përpunuar dhe raportuar një sistem të gjerë treguesish statistikorë, siç janë statistikatat e mbikëqyrjes bankare, statistikatat monetare dhe statistikatat e sektorit të jashtëm, si dhe publikon të dhëna të rëndësishme makroekonomike. Ajo është angazhuar në projektin për automatizimin e raportimit statistikor, për të plotësuar kërkesat e përdoruesve brenda vendit dhe për të përafuar sistemin raportues me standardet e BE-së.

9. Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2013, ka qenë një aktor kryesor në arritjen e marrëveshjes 3-vjeçare me FMN-në dhe mbetet një faktor i rëndësishëm gjatë gjithë procesit të zbatimit të saj.

10. Banka e Shqipërisë ka qenë një aktor i rëndësishëm në procesin e integritetit të vendit tonë në BE, nëpërmjet plotësimit të të gjitha detyrimeve të saj ligjore dhe angazhimeve institucionale.

11. Puna kërkimore e Bankës së Shqipërisë është përqendruar në trajtimin e problematikave të sistemit financiar, përcaktimin e tendencave të ekonomisë shqiptare dhe të ndikimeve që ato kanë në hartimin e politikave ekonomike e monetare. Ajo ka shërbyer si bazë për pasurimin e modeleve makroekonomike, mbi të cilat mbështetet vendimmarrja e politikave monetare.

12. Shpenzimet administrative, në trajtën e pagave, shpërblimeve apo shpenzimeve për udhëtime e dieta janë në përputhje me kuadrin ligjor, por vendimmarrja e Këshillit Drejtues të Bankës së Shqipërisë ka përcaktuar pagesa shumë të larta për nivelet drejtuese, krahasuar me ato të institucioneve të tjera kushtetuese. Gjithashtu, kostoja e institucionit rritet më tej nga tejkëqija e paarsyeshme e punimeve për rikonstruksionin e godinave

të tij, e cila shoqërohet me pagesat përkatëse të qirave. Këto problematika janë evidentuar edhe nga institucionet kushtetuese përgjegjëse.

**Kuvendi kërkon që, për vitin 2014, Banka e Shqipërisë të fokusojë më shumë punën në këto drejtime:**

1. Ndjekjen e një politike monetare lehtësuese e stimuluese, më fleksibël, për zhvillimin e ekonomisë dhe për vazhdimin e ruajtjes së stabilitetit makroekonomik e financiar të vendit, duke zbatuar kërkesat e akteve ligjore dhe rregullatore. Banka e Shqipërisë duhet të jetë më aktive në politikën e interesave, për të siguruar zhvillimin e brendshëm të ekonomisë reale dhe përputhjen me politikën monetare të Bankës Qendrore Europiane. Ajo duhet të jetë sinjalizuese e vazhdueshme e në kohën e duhur për zhvillimet dhe ndryshimet e pritshme në ekonomi dhe në tregjet financiare, duke rekomanduar masa parandaluese për të zbutur efektet, kur ato pritet të jenë negative.

2. Forcimin e mëtejshëm të rolit mbikëqyrës e rregullator ndaj sistemit bankar e financiar për të garantuar konkurrueshmëri funksionale të tregut, për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit dhe për të garantuar sigurimin e kursimeve të qytetarëve. Për këtë, Banka e Shqipërisë duhet të rrisë rolin mbikëqyrës dhe bashkëpunues me institucionet dhe autoritetet e tjera financiare bankare e jobankare. Kuadri rregullator dhe mbikëqyrës duhet të mbështetet në parimet e Komitetit të Bazelit "Bazel II" dhe në legjislationin e Bashkimit Europian. Ai duhet të synojë përmirësimin e sistemit të administrimit të rrezikut dhe të llogaritjes së nevojave të bankave për kapital.

3. Krijimin e stimujve për rritjen e kreditimit të ekonomisë reale, përfshirë rritjen e transparencës në procesin e kredidhënies, përcaktimin e rregullave që garantojnë pandryshueshmërinë e kushteve të kredidhënies në një periudhë afatshkurtër, si dhe stimulimin e një procesi të përbashkët për ristrukturimin e kredive për sipërmarrjet e prekura nga efektet e krizës, posaçërisht ato të sektorit prodhues e të eksportit. Këto masa duhet të sigurojnë zbutjen e politikave konservatore të bankave gjatë aktivitetit kreditues në drejtim të çmimit të kredisë, kolateralit apo kushteve të tjera, për të siguruar përmirësim të tregut financiar dhe rritje të shpejtë e të ekuilibruar të ekonomisë.

4. Reduktimin e kredive me probleme dhe përmirësimin e cilësisë së portofolit të kredive. Ky objektivi kërkon thellimin e punës mbikëqyrëse për trajtimin, zgjidhjen, ristrukturimin dhe shitjen e kredive me probleme, si dhe përmirësimin e administrimit të rrezikut të kredisë nga bankat e nivelit të dytë. Krahas këtyre masave mbikëqyrëse, Banka e Shqipërisë duhet të harmonizojë punën me strukturat ekzekutive dhe Kuvendin për të bërë përmirësime të tjera ligjore lidhur me pagesat e përbaruesve gjyqësorë dhe të huamarrësve, funksionimin

e tregut të pasurive të paluajtshme, ekzekutimin e kolateralit dhe falimentimin e bizneseve.

5. Menaxhimin eficient të rezervës valutore dhe investimin me përparësi brenda vendit, të likuiditetit të sistemit bankar, me qëllim forcimin e stabilitetit financiar dhe zhvillimin ekonomik të vendit, pa cenuar të drejtën e bankave tregtare për të ristrukturuar portofolin e tyre në funksion të stabilitetit financiar të vetë bankave. Në investimin e likuiditeteve brenda vendit përparësi duhet t'i jepet kreditimit të ekonomisë reale, krahasuar me investimin në letra me vlerë të Qeverisë, për të nxitur veprimtarinë e biznesit, e cila sjell më shumë punësim, investime dhe rritje ekonomike.

6. Forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e rolit rekomandues ndaj strukturave ekzekutive dhe Kuvendit gjatë procesit të hartimit të projektbuxhetit, për të përmirësuar programimin dhe parashikueshmërinë fiskale, si dhe për të ruajtur nivelin e borxhit publik në kufij të përballueshëm dhe të padëmshëm për ekonominë e vendit.

7. Banka e Shqipërisë duhet të bashkëpunojë më shumë me Qeverinë dhe institucionet financiare ndërkombëtare, për të reflektuar më mirë dhe për të përballuar më shumë rreziqet që burojnë nga mjedisi i pasigurt makroekonomik dhe financiar global, si vala e paqëndrueshmërisë globale financiare, rishfaqja e ndonjë stresi tjetër financiar në eurozonë, përkeqësimi i tregut të brendshëm lidhjet e forta financiare mes borxhit publik, sektorit bankar dhe fondit të investimeve (letrat me vlerë, obligacionet qeveritare)].

8. Krijimin e premisave për rritjen e numrit të përdoruesve të parasë elektronike në vendin tonë, të përdoruesve të shërbimit e-banking dhe shtimin e operatorëve të skemës kombëtare të pagesave me kartë, si faktorë që ndikojnë në uljen e informalitetit në ekonomi.

9. Zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve financiare të ofruara nga sistemi bankar, si dhe shtimin e produkteve të reja bankare.

10. Përafrimin e sistemit statistikor me standardet e BE-së, si dhe përmirësimin e shërbimit statistikor për publikun, nëpërmjet zgjerimit të bazës së treguesve statistikorë, rritjes së nivelit të detajimit, rritjes së shkallës së mbulimit dhe shkurtimit të afateve të publikimit.

11. Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë duhet të mbështetet në rritjen e cilësisë së punës kërkimore, nëpërmjet rritjes së profesionalizmit të stafit.

12. Bashkëpunimin me strukturat ekzekutive dhe Kuvendin për përmirësimin e kuadrit ligjor, si dhe shmangien e konfliktit të interesit që ekziston aktualisht në caktimin e pagës së Guvernatorit dhe në përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare. Lidhur me shpenzimet administrative, si paga, shpërblime etj., duhet vendosur një raport më i përshtatshëm i tyre me institucionet e tjera kushtetuese që reflekton edhe një sensibilitet publik për të tilla shpenzime.

13. Zbatimin me korrektësi të kontratave për ndërtimin dhe rikonstruksionin e mjediseve të institucionit, për të reduktuar kostot nga pagesat e qirasë apo shpenzime të tjera të larta në buxhetin e Bankës së Shqipërisë.

Miratuar në datën 19.6.2014

KRYETARI  
Ilir Meta

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2013

#### Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke njohur përparimet e mëtejshme të bëra në fushën e zbatimit të garancive për konkurrencën në tregun e komunikimeve elektronike, e shoqëruar kjo me uljen e tarifave;

- Duke e konsideruar si shumë të rëndësishëm forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të këtij rregullatori në përmbushjen e misionit të tij, veçanërisht me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të strukturës dhe organikës së re të AKEP-it;

- Duke pasur parasysh rolin e AKEP-it në promovimin e konkurrencës në rrjetet e komunikimeve elektronike, veçanërisht në garantimin që përdoruesit të përfitojnë maksimalisht nga këto shërbime;

- Duke qenë të vetëdijshëm se zhvillimet në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare, si një sektor shumë i specializuar dhe me një zhvillim të vazhdueshëm e dinamik, janë shoqëruar me hapa dhe procese të rëndësishme nga pikëpamja e organizimit, menaxhimit dhe administrimit të tij;

- Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që ka AKEP-i në tregun postar në Shqipëri;

- Duke vlerësuar që penetrimi i telefonisë fikse dhe brezit të gjerë vazhdon të mbetet i ulët;

- Duke pasur parasysh që AKEP-i ka rol të rëndësishëm në inkurajimin e përdorimit dhe menaxhimit eficient të radio-frekuencave dhe të serive numerike;

#### Konstaton se AKEP-i për vitin 2013:

- Ka bërë përparime të mëtejshme në fushën zbatimit të garancive për konkurrencën në tregun e komunikimeve elektronike, e shoqëruar kjo me uljen e tarifave;

- Ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh normative rregullatore, në fushën e komunikimeve elektronike, si

dhe ka vijuar përafrimin e tyre me legjislacionin e BE-së;

- Ka përmbushur, sipas parashikimeve, raundin e tretë të uljes së tarifave të shumicës për rrjetet celulare;

- Ka kryer, në përputhje me afatet ligjore të zbatimit të analizës së tregjeve, analizat e disa tregjeve, si “Analiza e tregut të telefonisë fikse”; “Analiza e tregut me shumicë të aksesit në broadband dhe LLU”; “Analiza e tregut të linjave me qira”; “Analiza e tregut me shumicë të terminimit të SMS-ve në telefoninë e lëvizshme;

- Ka miratuar dokumentin për “Statusin aktual dhe planin kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri”;

- Ka miratuar rregulloren për termat e përgjithshëm të kontratës së pajtimit, në kuadër të masave për mbrojtjen e konsumatorit dhe përdoruesve fundorë;

- Ka dhënë kontributin e tij në përgatitjen e ndryshimeve të Planit Kombëtar të Frekuencave dhe më tej ka miratuar implementimin e këtyre ndryshimeve në Planin e Përdorimit të Frekuencave;

- Ka vijuar përpjekjet për heqjen e barrierave administrative në procesin e lëshimit të autorizimeve individuale, duke informatizuar (përmes aplikimit online) sistemin e aplikimeve për pajisjen me autorizim për frekuenca dhe për numra;

- Ka realizuar liberalizimin e tregut të regjistrimit të domain nën.al, duke i dhënë të drejtën e regjistrimit edhe subjekteve të tjera të certifikuar nga AKEP-i;

- Ka hartuar dhe miratuar ndryshimet në Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;

- Ka përfunduar projektin për hartimin e rregullave dhe udhëzimeve për ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (AS/CA-Account Separation/Cost Accounting), për sipërmarrësit me FNT;

- Ka marrë masat e duhura rregullatore për kryerjen e regjistrimit të njoftimit të operatorëve që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;

- Ka vijuar përpjekjet për krijimin e kushteve për zbatimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nxitjes së përdorimit racional dhe eficient të burimeve të kufizuara (frekuencave dhe numeracionit);

- Ka vijuar përpjekjet në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përmirësimit të mbrojtjes së interesave të përdoruesve.

#### Kërkon nga AKEP-i për vitin 2014:

- Të rrisë dhe të forcojë më tej përpjekjet institucionale në mbrojtje të interesave të konsumatorit duke siguruar shërbime cilësore me tarifa sa më të ulëta në tregun e komunikimeve elektronike e postare në vend;

- Të marrë masa për zbatimin dhe bërjen efektive të strukturës dhe organikës së re të AKEP, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 11, datë 20.2.2014, për të bërë të mundur përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të AKEP-it, në mënyrë të veçantë funksionet rregullatore postare, për të cilat kishte mungesë në strukturën e mëparshme;

- Të ushtrojë autoritetin që i jep ligji që sipërmarrësit e telefonisë së lëvizshme të bëjnë sa më parë mbylljen e kontratave “kolektive” dhe regjistrimin e tyre me kontrata individuale, si dhe të ndjekë në dinamikë këtë problem;

- Të kryejë analizën e tregut të telefonisë celulare, duke analizuar në mënyrë të veçantë dominancën në treg, dhe të marrë masat e duhura në rast të konstatimit të abuzimeve me këtë dominancë;

- Të rrisë përpjekjet për përmirësimin e kapaciteteve administrative të tij;

- Të vazhdojë të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse dhe të aksesit broadband, të cilat mbeten në nivele të ulëta;

**- Të angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar kushtet e një konkurrence të ndershme dhe mosdiskriminuese, si dhe në rritjen e fleksibilitetit, efektivitetit dhe transparencës së ofrimit të shërbimeve, për mbarëvajtjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare;**

- Të marrë masat e nevojshme që kompanitë celulare të zbatojnë në mënyrë rigorozë dhe efektive kriteret për shitjen e kartave SIM;

- Të ndër marrë masa rregullatore për të lehtësuar dhe për të promovuar një zgjidhje të tregut për elemente të shërbimit universal, siç është mundësimi i numërorit telefonik apo shërbimi i kërkimit të informacionit në numëror dhe elemente të tjera;

- Të forcojë dhe të zgjerojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet, veprimtaria e të cilave është e lidhur dhe ndikon në çështje që kanë të bëjnë me tregun e komunikimeve elektronike dhe postare në Shqipëri;

- Të angazhohet përmes strukturave përkatëse të krijuara në plotësimin e kuadrit rregullator për funksionimin e tregut postar në veçanti, si dhe të vijojë me përmirësimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator;

- Të rrisë numrin e inspektimeve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe në rast konstatimi të shkeljeve të legjislacionit përkatës, të vendosë masa administrative sipas ligjit;

- Të vazhdojë të angazhohet në administrimin me efektivitet të spektrit të frekuencave;

- Të impenjohet në kryerjen e studimit, hartimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”, si dhe dhënien e të

drejtave të përdorimit sipas procedurës;

- Të angazhohet në kryerjen e studimit mbi mënyrën dhe kushtet e përdorimit të brezave të frekuencave 900/1800 MHz, hartimin e dokumenteve përkatëse, si dhe realizimin e procesit sipas procedurës;

- Të mbajë në mbikëqyrje të vazhdueshme situatën e dominancës në treg, sipas edhe rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës;

- Të kryejë rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e sipërmarrësve të telefonisë së lëvizshme, duke marrë parasysh edhe shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës për zhvillimin e këtij tregu;

- Të vijojë procedurat për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave për përdorim në teknologjinë 3G, sipas procedurave ligjore.

Miratuar në datën 19.6.2014

KRYETARI  
I Ilir Meta

**DEKRET**  
**Nr. 8599, datë 18.6.2014**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Meryem Ilyas Hastürk (Serbest)
2. Ledvent Hatim Yurtsever
3. Enkël Bedrush Çollaku
4. Tarek Ghassan Qub'ain
5. Veronica Victor Gjika (Belii)
6. Ali Kazim Pehlivan
7. Seren Salih Ertaş
8. Hekuran Florim Sahatqija
9. Shemsedin Enver Aliu
10. Bajram Teki Çela
11. Nuhi Ali Hamidi (Amidi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
Bujar Nishani

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 27.6.2014**

**PËR KRIJIMIN, FUNKSIONIMIN DHE PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE TË AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE, NË INSTITUCIONET PUBLIKE**

Në zbatim të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar me ligjin nr. 86/2012 datë 18.9.2012 dhe me ligjin nr. 45/2014 datë 24.4.2014, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)

**UDHËZON:**

1. Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin dhe funksionimin e strukturave të veçanta të autoriteteve përgjegjëse (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet e administratës publike qendrore dhe vendore, si më poshtë:

a) Ngritja e autoriteteve përgjegjëse në institucionet publike, bëhet bazuar në nenin 41, pika 2, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Përcaktimi/emërimi i anëtarëve të kësaj njësie bëhet me urdhër të titullarit të institucionit publik.

b) Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, si strukturë e veçantë, ndjek në vazhdimësi procesin e deklarimit të interesave private dhe konfliktin e interesave, për të gjithë zyrtarët e institucionit publik, duke mbajtur kontakte dhe marrëdhënie të vazhdueshme me ILDKPKI-në.

c) Autoriteti përgjegjës, për shkak të detyrave dhe kompetencave që përcakton ligji, duhet të jetë pjesë e drejtorisë/vektorit të Burimeve Njerëzore dhe vetëm në mungesë të kësaj strukture, eprori mund të emërojë si autoritet përgjegjës punonjës të tjerë të institucionit me formim jurist.

d) Pozicioni i nëpunësit/sve që do të kryejë detyrat e autoritetit përgjegjës duhet të përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit dhe në përshkrimin e vendit të punës.

e) Në përshkrimin e pozicionit të punës, për detyrën e autoritetit përgjegjës, vendosen kritere dhe për njohjen e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave.

f) Autoriteti përgjegjës i çdo institucioni duhet të jetë njësi apo strukturë, e cila duhet të ketë vazhdimësi në ushtrimin e funksioneve të saj.

g) Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të autoriteteve përgjegjëse, në zbatim të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, zyrtari i cili ka

kompetencë ligjore për emërimin, lëvizjen apo largimin e AP-së, duhet të njoftojë paraprakisht Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKPKI, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

h) Pas marrjes së njoftimit për lëvizjen apo largimin e AP-së, ILDKPKI shqyrton rastin dhe jep udhëzimet përkatëse lidhur me çështjen brenda një afati kohor 15-ditor.

2. Funksionimi dhe detyrat e autoriteteve përgjegjëse në drejtim të rolit parandalues

Autoriteti ose struktura përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, sipas nenit 41, pika 2, të tij, në përputhje me masën, mënyrën dhe radhën e përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, në këtë udhëzim, si dhe/ose në aktet nënligjore e rregulloret e brendshme të institucionit publik, me qëllim parandalimin e rasteve të konfliktit të interesave, në mënyrë aktive dhe në emër të institucionit publik përkatës, kryen këto detyra:

2.1 Mbledh nga burime të ligjshme të dhëna për interesat private të zyrtarëve.

a) Shpërndan dhe administron autorizimet e lëshuara nga zyrtarët në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar. Autorizimi sipas formatit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm, është i detyrueshëm për t'u plotësuar nga çdo zyrtar i cili kryen një funksion publik dhe nënshkruhet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës.

b) Në emër të institucionit publik, mbledh të dhëna personale për zyrtarin, kudo që ato janë të regjistruara në regjistrat publikë, të cilët lidhen me interesat private që mund të krijojnë ose duket sikur krijojnë konflikt interesi me funksionin publik apo detyrat që ushtron zyrtari.

Mbledhja e këtyre të dhënave duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

2.2 Propozon nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore, si dhe ndryshimet në rregulloret e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave të institucionit, në përputhje me ligjin e parandalimit të konfliktit të interesave, si dhe udhëzimeve të ILDKPKI.

3. Detyrat e autoriteteve përgjegjëse për konstatimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave

Autoriteti përgjegjës, në emër të institucionit, kryen verifikim dhe hetim administrativ lidhur me interesat private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi, në të gjithë regjistrat publikë apo institucione të tjera duke shfrytëzuar të gjithë mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë eprorin e drejtpërdrejtë deri tek titullari i institucionit:

a) Autoriteti përgjegjës pranon informacion të ofruar nga zyrtarë të tjerë apo persona të interesuar, të siguruar në mënyrë të ligjshme dhe verifikon/kontrollon burimin dhe vërtetësinë e këtyre të dhënave.

b) Në bazë të informacionit të grumbulluar, autoriteti përgjegjës, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, vlerëson nëse rasti konkret përbën konflikt interesi, duke analizuar njëkohësisht dhe rolin dhe kompetencat e zyrtarit në procesin vendimmarrës.

c) Verifikon dhe vlerëson nëse nga situata e konstatuar në kushte të konfliktit të interesit kanë ardhur pasoja.

d) I komunikon vetë zyrtarit dhe eprorit të dhënat e mbledhura dhe shkeljet e konstatuara, duke i orientuar gjithashtu për masat që duhet të marrë vetë zyrtari apo eprori për zgjidhjen e konfliktit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 37 dhe 38 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar.

e) Plotëson dhe administron regjistrin e konfliktit rast për rast të interesit, i cili duhet të përmbajë të dhëna lidhur me:

- i) identitetin e zyrtarit;
- ii) interesat private të tij, të cilët janë bërë shkak për një konflikt interesi;
- iii) thelbin e konfliktit;
- iv) palët e interesuara;
- v) burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe verifikimit të tyre;
- vi) vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprorë ose nga gjykatat.

f) Mbështet eprorin, sipas rastit, për marrjen e masave disiplinore dhe raporton rastin në ILDKPKI për ndjekje të mëtejshme.

4. Rregullimi i pasojave juridike, pavlefshmëria e akteve/ kontratave administrative të marra në kushtet e konfliktit të interesave

4.1 Autoriteti përgjegjës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse, e cila trajton çështjet juridike:

a) merr masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në kushtet e konfliktit të interesit;

b) siguron transparencën me publikun lidhur me vendimmarrjet e kryera nga institucioni përkatës dhe zbatimin me korrektësi të ligjit nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

4.2 Shtron çështje dhe kërkon këshilla nga ILDKPKI, për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, si dhe përmirësime në ligje të tjera kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave.

4.3 I propozon me shkrim organit kompetent (eprorit/institucionit epror) revokimin/shfuqizimin e akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesave.

4.4 Në rastet e konstatimit të pavlefshmërisë së një akti/kontrate administrative të institucionit publik, sipas përkufizimit të këtij termi në Kodin e Procedurave Administrative, si pasojë e nxjerrjes së tyre në kushtet e konfliktit të interesave (faktik apo në dukje), autoriteti përgjegjës, në bashkëpunim me strukturën përkatëse në

zbatim të nenit 40/1 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim:

a) I propozon eprorit/organit kompetent fillimin e procedurave të dënimit disiplinor ndaj zyrtarit, përgjegjës për pavlefshmërinë e aktit;

b) Propozon të ndërmerren procedurat për kalimin e barrës së dëmshpërblimit të ky zyrtar;

c) Inicion fillimin e procedurave të ankimit pranë organit gjyqësor, për vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;

d) Propozon të bëhet kallëzim penal ndaj zyrtarit, nëse gjykohet se shkelja e kryer nga ai përbën vepër penale.

Këto masa të sipërcituara mund të zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari tjetër përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e veta nuk ka parandaluar konfliktin e interesit, shkak për pavlefshmërinë e aktit, ose për moszbatimin e detyrimeve për shmangien e konfliktit të interesave të përcaktuara në ligj.

5. Roli këshillues dhe trajnues i autoriteteve përgjegjëse

a) Autoriteti përgjegjës i sugjeron zyrtarëve dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e konfliktit të interesit rast për rast ose të vazhdueshëm (faktik, në dukje dhe i mundshëm).

b) Mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave nga ILDKPKI në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar.

c) Përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit të tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;

d) Merr masa për të siguruar aksesin dhe informimin e publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit.

6. Detyrat e autoriteteve përgjegjëse në procesin e deklarimit

a) Autoriteti përgjegjës në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, duhet të përgatisë listën e përditësuar të zyrtarëve të cilët në varësi të funksionit që kryejnë mbartin detyrimin për deklarim të interesave private, dhe të dërgojë kopje të saj në ILDKPKI;

b) Në rastet e emërimeve dhe largimeve të zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim ILDKPKI-në, lidhur me datën e emërimit/largimit të subjekteve;

c) Orienton dhe udhëzon zyrtarët të cilët mbartin detyrim për deklarim për plotësimin në rrugë elektronike (me kompjuter) të deklarimit të interesave private sipas

llojeve (para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni);

d) Informon zyrtarët lidhur me afatet ligjore brenda të cilave plotësohet dhe dorëzohet deklarata e interesave private;

e) Informon zyrtarët lidhur me sanksionet në rast refuzimi për plotësim të deklaratës, në rast mosplotësimi brenda afatit, si dhe në rastin e deklarimeve të rreme;

f) Jep asistencë nëse kërkohet nga ana e zyrtarëve në plotësimin e deklaratave;

g) Mban databazë për shpërndarjen dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private të zyrtarëve dhe pasi verifikon se dokumenti zyrtar është pa mangësi, lëshon për subjektin vërtetimin e marrjes në dorëzim;

h) Mbledh deklaratat e plotësuara nga zyrtarët (subjekte të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe i dërgon pranë ILDKPKI-së, sipas listës emërore të dorëzimeve.

i) Përgatit jo më vonë se 31 janari i vitit pasardhës, raportin vjetor mbi veprimtarinë e kryer dhe e dërgon në ILDKPKI.

7. Raportimi vjetor mbi veprimtarinë e autoriteteve përgjegjëse

Në zbatim të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, autoritetet përgjegjëse i paraqesin Inspektoratit të Lartë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarimin periodik.

Raporti vjetor duhet të përmbajë:

a) Për procesin e deklarimit të interesave private periodike:

i) njoftimin, dhënien e konsulencës dhe dorëzimit të deklaratave të interesave private nga zyrtarët, si dhe respektimin e afateve ligjore nga ana e tyre;

ii) rakordimi i listës së zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarimin e interesave private;

iii) evidentimi i rasteve të mosrespektimit të afateve ligjore për dorëzimin e deklaratave të interesave private;

iv) evidentimi i marrjes së masave disiplinore për shkelje të konstatuara të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

b) Për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave:

i) plotësimin e autorizimit për parandalimin e konfliktit të interesave nga çdo zyrtar;

ii) identifikimin, regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave;

iii) raste të verifikuara dhe kontrolluara për konflikt interesi.

iv) raste të trajtuara dhe të zgjidhura të konfliktit të interesave;

v) raste të pazgjidhura të raportuara në ILDKPKI, gjykatë, prokurori.

8. Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave

a) Autoriteti përgjegjës duhet të respektojë gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tij (edhe pas largimit të zyrtarit nga funksioni), parimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

b) Në rastet kur konstatohen shkelje të detyrimeve ligjore nga kjo strukturë, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së i propozon titullarit të institucionit masë disiplinore, në zbatim të pikës 3 të nenit 45 të ligjit nr. 9367, si dhe ndërmerr procedurat për vendosjen e masave administrative “gjobë”, në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar.

9. Kryerja e detyrave dhe ushtrimi i kompetencave nga ana e autoriteteve përgjegjëse në funksion të parandalimit të konfliktit të interesave, duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, të përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi.

Bashkëlidhur këtij udhëzimi gjenden dokumentet e unifikuara, si më poshtë:

a) Autorizimi sipas nenit 10 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar (aneksi nr. 1);

b) Deklarimi rast pas rasti i interesave private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve publike (aneksi nr.2);

c) Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave (aneksi nr. 3);

d) Modeli i urdhrit për ngritjen e AP (aneksi nr. 4);

e) Administrimi i dokumentacionit nga AP (aneksi nr. 5);

f) Deklarimi i konfliktit të vazhdueshëm të interesave (aneksi nr. 6).

11. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

12. Udhëzimi 622, datë 30.11.2012, “Për ngritjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave”, shfuqizohet.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTORATIT  
TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE  
Shkëlqim Ganaj**



*Aneks nr. 1*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

*(Emërtimi i institucionit)*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

*(Qyteti) më, \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_*

**A U T O R I Z I M**

Unë, i nënshkruari, \_\_\_\_\_

*(emër, atësi, mbiemër)*

me funksion \_\_\_\_\_  
*(emërtimi i funksionit dhe institucionit publik)*

në datën \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_, në respekt të detyrimit tim ligjor sipas nenit 10, pika 2, dhe nenit 41 pika 2 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, autorizoj institucionin

*(emërtimi i institucionit publik ose i institucionit epror sipas pikës 10 të nenit 3 të ligjit nr. 9367)*

që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për personin tim, kudo ku ato janë të regjistruara dhe që lidhen me llojet e interesave private të përcaktuara në nenin 5, me përjashtim të atyre të dhënave personale të përcaktuara në pikën 4 të nenit 7 të këtij ligji. Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.

Autorizimi ka vlerë për të gjithë kohën që unë ushtroj detyrën publike, e cila është subjekt i kontrollit dhe i verifikimit sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Gjithashtu, ky autorizim ka vlerë për çdo kohë, pavarësisht nga mosvazhdimi i detyrës sime publike, por vetëm për ato të dhëna të interesave të mia private, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike në kohën e ushtrimit të saj.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna personale, të kryera nga institucionet, ose personat e autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, nuk duhet t’u nxjerrë pengesë personave konkretë që posedojnë origjinalin ose kopjen e njësuar me origjinalin të këtij autorizimi e të ngarkuar zyrtarisht, sipas ligjit për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna të interesave të mia private. Në bazë të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar,

personi i ngarkuar për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, që vihet në dijeni për të dhënat personale të autorizuesit, detyrohet të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

**AUTORIZUESI**

*(Emër, mbiemër, nënshkrimi)*

**TITULLARI I INSTITUCIONIT  
(OSE I INSTITUCIONIT EPROR)**

*(Emër, mbiemër, nënshkrimi)  
(Vula e institucionit)*

Aneks nr. 2

**DEKLARIM**  
**RAST PAS RASTI I INTERESAVE PRIVATE TË ZYRTARIT**  
**NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE**

**Kush mbart detyrimin për deklarin rast për rast të interesave private:**

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

**Llojet e deklarinimit:**

- 1- Vetëdeklarim paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesave private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi
- 2- Deklarim rast për rast të interesave private të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror.

**Të dhëna personale:**

Emri            – Atësia            – Mbiemri            – Funksioni            – Institucioni

Lloji i deklarinimit: (vendos X në kutizën për llojin e deklarinimit)

- Me kërkesë të \_\_\_\_\_
- Vetëdeklarim

**Vërtetohet se deklarinimet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.**

- 1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt interesi:

\_\_\_\_\_

2. Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi:

\_\_\_\_\_

- 3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

\_\_\_\_\_

Data e dorëzimit të deklarinatës \_\_\_\_\_

**Emri, mbiemri, nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Aneks nr. 3**Republika e Shqipërisë  
Institucioni \_\_\_\_\_

Datë \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_\_

**REGJISTRI VJETOR I EVIDENTIMIT DHE ZGJIDHJES SË RASTEVE TË KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Funksioni	Data e evidentimit	Përshkrimi i konfliktit të interesit	Burimi i të dhënave dhe verifikimi	Mënyra dhe data e zgjidhjes së konfliktit	Shënime
1									
2									
3									
4									
5									

**Shënim.** Ky regjistër është pjesë e raportit vjetor për veprimtarinë e kryer në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në të cilën duhet të evidentohen rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarin periodik. Sqarimet në lidhje me rastet e konflikteve të interesave të detajohen në raportin vjetor të autoritetit përgjegjës. **Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave duhet të dërgohet i plotësuar në Inspektoratin e Lartë brenda datës 31 janar të çdo viti.**

Autoriteti përgjegjës  
\_\_\_\_\_

Aneks nr. 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(Emërtimi i institucionit)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë, \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_

**U R D H Ë R**

Nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**PËR “NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE”**

Në mbështetje të nenit 41, pika 2, germa “b” dhe nenit 42, pika 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar dhe ligjit.....(*ligji përkatës i institucionit*),

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.
2. Caktimin e:
  - znj/z. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_ (*drejtor i drejtorisë/njesisë së burimeve njerëzore; ose përgjegjës personeli; ose juristin e institucionit, etj.*)
  - znj/z. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_ (*specifiko*) - znj/z. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_ (*specifiko*), si anëtarë të njesisë autoritet përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.
3. Drejtuesi i njesisë autoritet përgjegjës caktohet z/znj. \_\_\_\_\_. Drejtuesi i njesisë bën ndarjen e punës mes anëtarëve.
4. Njësia e ngritur në pikën 1 të këtij urdhri si autoritet përgjegjës do të mbajë në vijimësi kontaktet me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.  
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

TITULLARI I INSTITUCIONIT

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

**Aneks nr. 5**

**Administrimi i dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës**

Për administrimin e këtij dokumentacioni autoriteti përgjegjës duhet të mbajë disa dosje:

1. Dosja nr. 1 me titull “Për aktet ligjore dhe nënligjore” duhet të përmbajë:

- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar);
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar);
- Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligjet organike në varësi të veprimtarisë së institucionit publik
- Komentarët ligjorë të ILDKPKI-së;
- Urdhra dhe udhëzime të ILDKPKI-së, ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim;
- Botime të tjera të ILDKPKI-së.

2. Dosja nr. 2 me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave” duhet të përmbajë:

- a) Regjistri i konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
- b) Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarin rast për rast të interesave;
- c) Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
- d) Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
- e) Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë.

3. Dosja nr. 3 me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe interesave të zyrtarëve që bartin detyrimin për ILDKPKI” duhet të përmbajë:

- Regjistrin themeltar alfabetik, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
- Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarin dhe konfirmimet e tyre;
- Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
- Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
- Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit

**Kujdes!** Në rast largimi nga detyra e autoritetit përgjegjës, zyrtari/zyrtarët duhet të bëjnë dorëzimin e plotë të dokumentacionit të mësipërm me procesverbal dhe inventar të detajuar, pranë drejtorisë/njesisë së burimeve njerëzore, e cila më pas ia dorëzon zyrtarit/zyrtarëve të rinj.

Aneks nr. 6

## DEKLARIM

### PËR KONFLIKTIN E VAZHDUESHËM TË INTERESAVE PRIVATE NGA ZYRTARI NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK

#### Mbartin detyrimin për deklaram të konfliktit të vazhdueshëm të interesave private:

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit publik.

#### Llojet e deklaramit:

- 1- Vetëdeklarim para fillimit të detyrës, të ekzistencës së interesave private, të cilat bëhen shkak për lindjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesave.
- 2- Deklarim i interesave private të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror, për shkak të funksionit.

#### Të dhëna personale:

Emri - Atësia - Mbiemri - Funkzioni - Institucioni

Lloji i deklaramit: (vendos X në kutizën për llojin e deklaramit)

- Vetëdeklarim  
 Me kërkesë

**Vërtetohet se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.**

1-Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt interesi:

2- Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi:

3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

Data e dorëzimit të deklaramtës \_\_\_\_\_

Emri, mbiemri, nënshkrimi  
\_\_\_\_\_

### VENDIM Nr. 45, datë 16.6.2014

#### PËR AUTORIZIMIN E ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË "CEZ SHPËRNDARJE" SHA

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013, "Për heqjen e licencave të shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik, me pakicë të energjisë elektrike", të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të

ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 21.1.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, "Për vendosjen e shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013, "Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a., vendimit nr. 118, datë 18.10.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERES-s, "Për emërimin e administratorit të përkohshëm të shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a.", si dhe nenit 11, pika 1, e rregullores, "Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për

sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës.....2014, pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, dërguar me shkresën nr. 3704, datë 13.6.2014 “Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “CEZ a.s”,

**VENDOSI:**

1. Autorizohet z. Arben Seferi, administrator i përkohshëm i shoqërisë “Cez Shpërndarje” sh.a., që të marrë pjesë në procesin e finalizimit të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s.

2. Në rast të arritjes së një marrëveshjeje, autorizohet z. Seferi, që të nënshkruajë marrëveshjen dhe çdo instrument që i bashkëlidhet asaj, në emër të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” (në administrim të përkohshëm).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Petrit Ahmeti**

**VENDIM  
Nr. 46, datë 16.6.2014**

**PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË ENTIT  
RREGULLATOR TË ENERGJISË**

Në mbështetje të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të pikës 4 të nenit 7 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.6.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, dërguar me shkresën nr. 3704, datë 13.6.2014, “Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë CEZ a.s.”,

**VENDOSI:**

1. Autorizohet z. Petrit Ahmeti, kryetar i Entit Rregullator të Energjisë, që të marrë pjesë në procesin e finalizimit të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s.

2. Në rast të arritjes së një marrëveshjeje, autorizohet z. Ahmeti, që të nënshkruajë marrëveshjen dhe çdo instrument që i bashkëlidhet asaj, në emër të Entit Rregullator të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Petrit Ahmeti**

**KËRKESË  
Nr. 3240, datë 17.6.2014**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qukës - Qafë-Plloçë, loti 1 (devijimi)”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me kuadrin ligjor.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e shpronësimit është 6 313 446 (gjashtë milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekë.

Pronarët për të cilët në kolonën “Shënime”, në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave.

**MINISTRI I TRANSPORTIT DHE  
INFRASTRUKTURËS  
Edmond Haxhinasto**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR  
"QUKËS-QAFË PLOÇË" LOTI I (DEVIJIMI I AKSIT)

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Numri i Pasurisë	Sip. Totale (m2)	Tokë Arë			Kult. Bujq Drufutore (Lek)	SHUMA TOTALE (Lek)	Shënime
							Sip.	Çmimi (lek/m2)	Shuma (Lek)			
<b>FSHATI QUKËS-SHKUMBIN Z.K.3120</b>												
1	Agim	Sali	Leka	3120	443/43	867	540	149	80460	94480	174940	Konf. ZVRPP
2	Agim	Sali	Leka	3120	443/45	550	200	149	29800	15400	45200	Konf. ZVRPP
<b>FSHATI KARKAVEC Z.K.2096</b>												
3	Demir	Merko	Blloshim	2096	363/4	8312	1780	217	386260	205800	592060	Konf. ZVRPP
4	Demir	Merko	Blloshim	2096	363/7	1360	390	217	84630		84630	Konf. ZVRPP
<b>FSHATI BËRZESHTE Z.K.1169</b>												
5	Haki		Blloshmi	1169	175	2977	346	184	63664	46640	110304	Konf. ZVRPP
6	Hamit		Dashballa	1169	177	2509	1256	184	231104	25640	256744	Konf. ZVRPP
7	Islam		Blloshmi	1169	178	4667	1595	184	293480	119800	413280	Konf. ZVRPP
8	Dilaver		Blloshmi	1169	223/1	4368	1310	184	241040	25650	266690	Konf. ZVRPP
9	Dilaver		Blloshmi	1169	223/2	500	375	184	69000	2240	71240	Konf. ZVRPP
10	Sherif		Blloshmi	1169	224	4700	1890	184	347760	46560	394320	Konf. ZVRPP
11	Xheladin		Zharri	1169	226/2	8044	5195	184	955880	100500	1056380	Konf. ZVRPP
12	Behare		Leka	1169	1059/2	15937	1540	184	283360	193600	476960	Konf. ZVRPP
	Dashamir		Leka									
	Ilirjan		Leka									
13	Shefqet		Leka	1169	1059/4	14112	747	184	137448	93900	231348	Konf. ZVRPP
14	Petref		Leka	1169	1060/2	4500	1110	184	204240	111100	315340	Konf. ZVRPP
15	Fejzie		Leka	1169	1060/3	4500	2500	184	460000	47500	507500	Konf. ZVRPP
16	Fejzie		Leka	1169	1061/2	10000	310	184	57040	96000	153040	Konf. ZVRPP
17	Demir		Leka	1169	1062/1	3500	673	184	123832	10650	134482	Konf. ZVRPP
18	Zenel		Leka	1169	1062/2	10000	637	184	117208	9750	126958	Konf. ZVRPP
19	Agime		Frakulli	1169	1062/3	2400	435	184	80040	7750	87790	Konf. ZVRPP
20	Adil		Xhabani	1169	1062/4	2400	505	184	92920	9600	102520	Konf. ZVRPP
21	Pellumb		Leka	1169	1063/1	3875	1245	184	229080		229080	Konf. ZVRPP
22	Pellumb		Leka	1169	1063/2	1875	1385	184	254840	40480	295320	Konf. ZVRPP
23	Pellumb		Leka	1169	1066	3500	430	184	79120		79120	Konf. ZVRPP
24	Qamil		Alla	1169	265	9281	500	184	92000	16200	108200	Konf. ZVRPP
<b>SHUMA</b>							<b>26894</b>		<b>4994206</b>	<b>1319240</b>	<b>6313446</b>	



**KËRKESË**  
**Nr. 2990/2, datë 18.6.2014**  
**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtimi i rrjetit kryesor të kanalizimeve dhe Impiantit të Përpunimit të Ujërave të Përdorura në Plazhin e Velipojës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është “Ujësjiellës Fshat” sh.a., Shkodër. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me kuadrin ligjor.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet

e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e shpronësimit është 4 681 940 (katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekë.

Pronarët për të cilët në kolonën “Shënime”, në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave.

**MINISTRI I TRANSPORTIT DHE  
 INFRASTRUKTURËS  
 Edmond Haxhinasto**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE  
 DREJTORIA E PROJEKTEVE IPA

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA PËR ZONËN E VELIPOJËS**

Fshati “Paluaj”, ZK.3072, Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadas.	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe totale	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Tokë pemëtore		Vlera totale (lekë)	Shënime
								Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)		
1	Emiljan	Nik	Nika	3072	966/7	8,050	8050	262	2109100	2109100	Konfirmim ZRPP
2	Luigj	Dede	Suka	3072	966/5	9,820	9820	262	2572840	2572840	Konfirmim ZRPP
										<b>4681940</b>	

**KËRKESË**

Shtetasja Irena Gjoni e datëlindjes 18.8.1970, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të vdekur të ish-bashkëshortit të saj, shtetasit Arben Koti, i datëlindjes 3.6.1961.

**KËRKUESE  
 Irena Gjoni**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 20 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006